



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Rr. Xhorxh Bush, Nr. 31, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +383 38 244 183 / 244 186 | E-mail: rektorati@uni-pr.edu

Ueb: www.uni-pr.edu

Nr. Prot: 1/746

Datë: 29 / 5 / 2026

Senati i Universitetit të Prishtinës, në kuadër të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 147, pika 3.9 të Statutit të UP-së, në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Rregulloren me nr. 2/254, datë 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e profesorëve dhe asistentëve për ligjërata dhe ushtrime në Universitetin e Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 01.04.2026, vendosi të shpallë:

THIRRJE PUBLIKE

Për angazhim të profesorëve dhe asistentëve për ligjërata, respektivisht ushtrime në bazë të nevojave të njësive akademike të Universitetit të Prishtinës për vitin akademik 2026/27

Angazhimi me honorar (*ad junct*) i profesorëve për ligjërata dhe i asistentëve për ushtrime do të bëhet sipas propozimeve të njësive akademike, në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë, dispozitat e Statutit të Universitetit të Prishtinës, Rregulloren me nr. 2/254, datë 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e profesorëve dhe asistentëve për ligjërata përkatësisht ushtrime në UP, Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, si dhe standardet e miratuara nga AKA-ja dhe Rregulloren në fuqi për të ardhurat personale të personelit akademik të UP-së.

I. Procedura e angazhimit sipas thirrjes dhe përjashtimet për kategoritë e caktuara

Procedura e angazhimit të profesorëve dhe asistentëve (*ad junct*) për ligjërata, respektivisht për ushtrime bëhet nëpërmjet shpalljes së **THIRRJES PUBLIKE**, bazuar në Rregulloren me nr. 2/254, datë 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm.

II. Kushtet e angazhimit

1. Personat e angazhuar në procesin mësimor përmes kësaj thirrjeje nuk marrin titull akademik. Angazhimi i tyre bëhet bazuar në procedurat specifike të përcaktuara në Rregulloren me nr. prot. 2/254, datë 17.07.2024, për procedurat vlerësuese për angazhimin e profesorëve dhe asistentëve të angazhuar në UP.

2. Për pozitën e **profesorit/mësimdhënësit** të angazhuar për ligjërata, kandidatët duhet t'i plotësojnë këto kushte:
- Të ketë të paktën gradën shkencore Master i shkencave/arteve¹, ndërsa kandidatët me gradën Doktor i shkencave, nga lëmi përkatës (në Fakultetin e Arteve ekuivalente me të), kanë përparësi.
 - Të ketë së paku 1 publikim në revistat shkencore ndërkombëtare (në Fakultetin e Arteve së paku 1 vepër artistike të rangut ndërkombëtar në fushën përkatëse). Për pozitën e **profesorit** të angazhuar për ligjërata në mjekësi, në lëndët klinike, kandidati duhet të jetë specialist i fushës përkatëse.
3. Për pozitën e **asistentit** të angazhuar për ushtrime, kandidatët duhet t'i plotësojnë këto kushte:
- Të ketë të përfunduar studimet master ose ekuivalente me të në fushën përkatëse.
 - Të ketë notën mesatare jo më të vogël se 8 në të dy nivelet e studimit.
 - Në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë (në lëndët klinike të veterinarisë) dhe në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (në lëndët laboratorike²) kandidati duhet të dëshmojë që ka së paku 3 vjet përvojë pune profesionale në fushën përkatëse.
 - Në Fakultetin e Mjekësisë (në lëndët klinike), kandidati duhet të ketë të përfunduar specializimin ose të jetë së paku në vitin e tretë të specializimit në fushën përkatëse. Angazhimi bëhet duke marrë parasysh edhe Ligjin për Shëndetësi.
 - Në Fakultetin Ekonomik, për ushtrimet në lëndët e kontabilitetit dhe auditimit, kandidati duhet të jetë kontabilist, përkatësisht auditor i certifikuar sipas legjislacionit në fuqi dhe të ketë së paku 3 vjet përvojë pune profesionale në fushën përkatëse.
4. Bazuar në Rregulloren nr. 2/254, dt. 17.07.2024, vlerësimi dhe propozimi i kandidatëve për emërim bëhet nga komisioni vlerësues i cili themelohet në nivel të njësive akademike.

III. Fondi i orëve për të angazhuarit

1. **Mësimdhënësit** e jashtëm të angazhuar mund të mbajnë deri në **6** orë ligjërata në javë.
2. **Asistentët** e jashtëm të angazhuar mund të mbajnë deri në **10** orë ushtrime në javë.

IV. Periudha e angazhimit dhe kompensimi

1. Angazhimi i profesorëve dhe asistentëve bëhet për një semestër, përkatësisht për dy semestra të të njëjtit vit akademik, ndërsa kontrata lidhet për vitin akademik përkatës.
2. Pas vlerësimit pozitiv për profesorë dhe asistentë, me propozim të dekanit, angazhimi mund të vazhdohet edhe për 1 vit akademik, jo më shumë se dy vite tjera (4 semestra), pa shpallur thirrje publike. Propozimi i arsyetuar i dekanit duhet të miratohet në senat.

¹ Kandidati me gradën shkencore master duhet të ketë notën mesatare jo më të vogël se 8 në të dy nivelet e studimit.

² Lista e lëndëve klinike të Fakultetit të Mjekësisë, lëndëve klinike të fushës së veterinarisë, lëndëve laboratorike të Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike dhe lëndët e kontabilitetit dhe auditimit në Fakultetin Ekonomik është e publikuar në web faqen e Universitetit të Prishtinës dhe të fakulteteve përkatëse.

3. Kompensimi për angazhim bëhet në bazë të orëve të realizuara, respektivisht për semestrin/at për të cilët angazhohet për mbajtjen e ligjëratave/ushtrimeve, sipas kohëzgjatjes së semestrit të bazuar në Statutin e UP-së.
4. Vlera e kompensimit të profesorëve dhe asistentëve të angazhuar është e përcaktuar në Rregulloren për të ardhura personale të personelit akademik, e cila është në fuqi në momentin e nënshkrimit të kontratës.
5. I angazhuari ka për obligim që në kuadër të kontratës të mbajë provimet për të gjitha afatet brenda vitit përkatës akademik.
6. I angazhuari, nëse ka titullin dr. sc. ose ekuivalent me të në Fakultetin e Arteve, ka të drejtë të mentorojë kandidatët në nivelin bachelor.
7. I angazhuari mund të jetë anëtar i komisionit për mbrojtjen e temave në nivelin bachelor dhe master.

V. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

Kandidatët që aplikojnë për profesorë dhe asistentë të angazhuar duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- a) Kërkesën për aplikim;
- b) Biografinë (CV);
- c) Certifikatën/ekstraktin e lindjes;
- ç) Kopjen e diplomës përkatëse të vërtetuar me vulë origjinale nga noteri, për pozitën që aplikon;
- d) Kandidatët që i kanë mbaruar studimet jashtë vendit me rastin e aplikimit për angazhim duhet të ngarkojnë vendimin për nostrifikim (barasvlerë) të diplomës përkatëse (bachelor, master, magjistraturë, doktoratë).
- dh) Kandidatët, të cilët konkurrojnë për pozitën e **asistentit** të angazhuar për ushtrime, lektorit dhe korepetitorit duhet të sjellin edhe certifikatën origjinale të notave të studimeve bachelor dhe atyre master, ose kopjen e noterizuar me vulë origjinale nga noteri;
- e) Dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale;
- ë) Dëshmitë eventuale për angazhimet paraprake në UP ose në ndonjë institucion të akredituar të arsimit të lartë.
- f) Dëshmi të lëshuar nga gjykata kompetente, përmes së cilës dëshmohet që kandidati nuk është i dënuar.
- g) Dëshmi tjera relevante për pozitën në të cilën aplikon.

VI. Komisioni vlerësues dhe e drejta e ankesës

1. Për formimin e komisionit vlerësues dhe procedurat e implementimit vlejné dispozitat e Rregullores me nr. 2/254, datë 17.07.2024.
2. E drejta e ankesës dhe afatet e ankesës janë të përcaktuara me dispozitat e Rregullores me nr. 2/254, datë 17.07.2024.
3. Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë ankese pranë komisionit për ankese në fakultetin përkatës, brenda 5 ditëve nga publikimi i raportit të Komisionit vlerësues në ueb-faqe.
4. Vendimi i këshillit të fakultetit, me listën e kandidatëve të pranuar si profesorë dhe asistentë të angazhuar, dërgohet në Senat për informim.

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në versionin elektronik brenda afatit të thirrjes publike, në modulën përkatës të sistemit të Universitetit të Prishtinës, në linkun në vijim: <https://stafiakademik.uni-pr.edu>

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Thirrja publike publikohet në faqen zyrtare të UP-së <https://www.uni-pr.edu>, dhe në web-faqet e njësive akademike përkatëse, duke filluar nga data 29 maj 2026.

Aplikimi do të jetë i hapur nga data 1 qershor 2026 deri më 10 qershor 2026.

Thirrja publike shpallet sipas propozimeve të njësive akademike si në vijim:

I. FAKULTETI FILOZOFIK

1. Një mësues për lëndët: Mirëqenia e fëmijëve (O), Komunikimi profesional (Z).
2. Një mësues për lëndët: Aftësia e kufizuar - studime kritike (O), Migrimi dhe kthimi (Z).
3. Një asistent për lëndët: Hyrje në punë sociale I (O), Hyrje në Psikologji (O), Këshillim psiko-social (O), Puna sociale me persona në konflikt me ligjin (O), Legjislacion i punës sociale (O), Puna vullnetare (O), Kultura dhe puna sociale (Z).
4. Një asistent për lëndët: Hyrje në Sociologji (O), Hulumtimet kualitative (O), Mirëqenia e fëmijëve (O), Migrimi dhe kthimi (Z), Puna sociale me familje (O), Shëndeti mental në komunitet (O) Psikologji zhvillimore (Z).
5. Një asistent për lëndët: Shkrim akademik (Z), Gjinia dhe diversiteti (O), Aftësia e kufizuar - studime kritike (O), Komunikimi profesional (Z), Psikologji sociale (O), Avokimi dhe fuqizimi (Z).
6. Një asistent për lëndët: Filozofi e mesjetës (Z), Pushteti, shteti dhe shoqëria (O), Nacionalizmi sot (Z), Marrëdhënie ndërkombëtare (O), Teoritë e kushtetutshmërisë (O), Filozofi kognitive (Z), Variacionet e barazisë dhe lirisë (Z), Filozofi e të drejtave të njeriut (Z), Filozofi e mediave (Z), (MA).
7. Një asistent për lëndët: Logjikë deduktive (O), Filozofi analitike (O), Filozofi e shkencës (O), Arti dhe politika (O), Temat kryesore dhe metodat në filozofi politike (O), Hyrje në teori të njohjes (O), Filozofi e logjikës (O), Hyrje në metafizikë dhe ontologji (O), Filozofi e religjionit (O), Hegeli dhe filozofia e shek.19 (Z).

II. FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE

1. Një mësues për lëndët: Për lëndë nga fusha e Shkencave kompjuterike.
2. Dy asistentë për grup lëndësh nga programi i Matematikës.
3. Dy asistentë për grup lëndësh nga fusha e Shkencave kompjuterike.
4. Një asistent për grup lëndësh nga Kimia analitike.

III. FAKULTETI I FILOLOGJISË

1. Një mësues për lëndët: Hyrje në mësuesi dhe mësuesi (BA), Testimi dhe vlerësimi (BA), Hyrje në mësuesi dhe mësuesi (BA), Planifikimi i orës mësimore (BA), Mësuesi e anglishtes për grupmoshat e reja (BA).
2. Një asistent për lëndët: Hyrje në gramatikën e gjuhës gjermane (BA) dhe Gramatikë e gjuhës gjermane (BA).

3. Një asistent për lëndët: Zhanret e gazetarisë I, Media dhe politika, Sistemi politik i BE-së, Zhanret e gazetarisë II, Intervista&Talk Shou, Sistemi politik i BE-së.
4. Një asistent për lëndët: Gazetari e televizionit, Prezantim dhe moderim, Gazetari Sportive, E drejta e medias dhe politikat mediale, Hyrje në teorinë e komunikimit, Hulumtimi i Audiencës.
5. Një asistent për lëndët: Redaktimi në media, Produksion dhe postproduksion, Komunikimi strategjik, Komunikimi politik, Komunikimi në kohë krize.

IV. FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT

1. Një mësues për lëndët: Baza e të dhënave, Matjet e tokës, Bazat e gjeodezisë inxhinierike, Teknika e matjeve në gjeodezi, Bazat e të dhënave gjeohapësinore dhe integrimi i të dhënave, Matjet inxhinierike (përfshihen minierat).
2. Një asistent për lëndët: Fundimet e veçanta, Bazat e gjeoteknikës, Bazat e projektimit të rrugëve (K), Projektimi i rrugëve (H), Gjeologjia inxhinierike, Inxhinieri gjeoteknike.
3. Një asistent për lëndët: Teoria e strukturave I, Teoria e strukturave II, Analiza jolineare e strukturave, Stabiliteti i strukturave dhe strukturat hapësinore, Rezistenca e strukturave ndaj zjarrit, Hyrje në inxhinierinë e strukturave.
4. Një asistent për lëndët: Instrumente gjeodezike, Bazat e të dhënave gjeohapësinore dhe integrimi i të dhënave, Web GIS, Matjet inxhinierike (përfshihen minierat), Sistemet referente gjeodezike, Baza e të dhënave, Web hartografi, Bazat e gjeodezisë inxhinierike, Teknika e matjeve në gjeodezi.
5. Një asistent për lëndët: Hartografi topografike, Aplikimi i GIS-it, Gjeovizualizimi, Vrojtimi i tokës, Hartografi, Hartografi matematike, Modelimi virtual kartografik.
6. Një asistent për lëndët: Përdorimi i gjeoinformacioneve, Hulumtimet nga largësitë, Metodot e barazimeve, Teoria e avancuar e gabimeve, Regjistrimi dhe vlerësimi i patundshmërive, Fotogrametria e avancuar digjitale, Skenimi laserik tredimensional në gjeodezi dhe gjeoinformatikë.
7. Një asistent për lëndët: Matematikë I (BSc, K), Matematikë I (BSc, H), Matematikë I (BSc, IA), Algjebër lineare (BSc, Gj), Metodot numerike (BSc, K), Gjeometri diferenciale (BSc, Gj), Matematikë (BSc, Ark), Matematikë II (BSc, K), Matematikë II (BSc, H), Matematikë II (BSc, IA), Analizë matematikore (BSc, Gj), Propabilitet (BSc, K), Gjeometri llogaritse (BSc, Gj).
8. Një asistent/lektor për lëndën: Gjuhë angleze.

V. FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE

1. Një mësues për lëndët: Arkitekturat paralele dhe modelet e programimit (Z), Gërmimi i të dhënave (Z).
2. Një mësues për lëndët: Biometrics&Forensics (Z).
3. Një mësues për lëndët: Modelet e mëdha gjuhësore (Z), Analiza e të dhënave të mëdha (Z).
4. Një asistent për lëndët: Analiza e të dhënave (Z), Përgatitja dhe vizualizimi i të dhënave, Procesimi i gjuhëve natyrore (Z), Rrjetat kompjuterike, Hyrje në modelet e mëdha gjuhësore (Z).
5. Një asistent për lëndët: Bazat e programimit, Algoritmet dhe strukturat e të dhënave.

6. Një asistent për lëndët: Bazat e programimit, Algoritmet dhe strukturat e të dhënave, Algoritmet e inspiruara nga natyra (Z).
7. Një asistent për lëndët: Bazat e të dhënave, Programimi në ueb (I) nga ana e klientit, Programimi në ueb (2) nga ana e serverit, Sistemet e shpërndara.

VI. FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

1. Një mësues për lëndët: Elektroteknika (O, BA), Ngasja elektrike (O, BA), Sinjalet dhe matjet (O, MA).
2. Një mësues për lëndët: Gjuhë angleze (O, BA), Gjuhë angleze (Z, BA).
3. Një mësues për lëndët: Gjuhë gjermane (O, BA), Gjuhë gjermane (Z, BA).
4. Një mësues për lëndët: Inxhinieri industriale (kapitujt: E-Biznes dhe E-Comerce) (O, BA).
5. Një mësues për lëndët: Inxhinieri industriale (kapitujt: Ndërmarrësi dhe inovacion, Certifikimi i produktit) (O, BA).
6. Një asistent për lëndët: Dëmtimet e sistemeve makinerike (Z, BA), Konstruksionet metalike (O, MA), Bazat e makinave (Z, BA), Dëmtimet e sistemeve makinerike (Z, BA), Detalet e makinave I (O, BA), Dizajnimi ekologjik (ECO design) (Z, MA), Optimalizimi i mjeteve transportuese (Z, MA), CAE (O), Detalet e makinave (O, BA).
7. Një asistent për lëndët: MEF (Z, MA), Projektimi i mjeteve transportuese (O, BA), MA, Detalet e makinave (O, BA), Kinematika (O, MA), Konstruksioni i automjeteve (O, MA), Metodot numerike të modelimit (Z, MA) Makinat ndërtimore dhe minerore (O, MA).
8. Një asistent për lëndët: Zhvillimi i produkteve (O, BA), Metodot e llogaritjes së automjeteve motorike (O, MA), Dinamika e sistemeve shumë truporë (O, MA), Mjetet hekurudhore (Z, BA), Rezistenca e materialeve (O, BA), Metodika e konstruktimit (O, MA), Homologimi i automjeteve motorike (Z, MA), Dinamika e mjeteve transportuese (O, MA).
9. Një asistent për lëndët: Automjetet hibride dhe elektrike (Z, BA), Diagnostifikimi i automjeteve (O, MA), Konstruktimi me kompjuter (Z, BA), Inxhinieria kthyesë (Z, BA), Dizajnimi i motorëve (O, MA), Simulimet kompjuterike në zhvillimin e motorëve dhe automjeteve (Z, MA), Automjetet motorike (O, BA), Analiza dhe sinteza e mekanizmave (O, BA), Motorët me djegie të brendshme (Z, BA).
10. Një asistent për lëndët: Sistemet e kondicionimit të ajrit (O, MA), Analiza hidraulike e rrjeteve termike (Z, MA), Transmetimi i nxehtësisë dhe masës (O, MA), Projektimi dhe optimizimi i sistemeve termike (O, MA), Projektimi dhe optimizimi i sistemeve termike (Z, MA), Bazat e energjisë së ripërtëritshme (O, BA), Ekonomia dhe planifikimi i energjisë (Z, MA), Mekanika e fluideve II (O, BA), Termocentralet (O, MA).
11. Një asistent për lëndët: Menaxhimi në energjetikë (O, MA), Menaxhimi në energjetikë (Z, MA), Meteorologjia (Z, BA), Sistemet e energjisë gjeotermale (O, MA), Sistemet e energjisë së erës (O, MA), Sistemet e djegies (O, MA), Pompat termike (O, MA), Pompat termike (Z, MA), Menaxhimi i projekteve (Z, BA), Stabilimentet termoenergjetike (O, BA), Mbrojtja e ambientit (Z, BA).
12. Një asistent për lëndët: Furnizimi i ndërtesave me energji të ripërtëritshme (Z, BA), Termodinamika II (O, BA), Ekonomia energjetike (Z, BA), Sistemet e energjisë së biomasës (O, MA), Efiçienca e energjisë në pajisjet termike (Z, MA), Analiza e sistemeve energjetike (Z, MA), Socio-ekonomia në energjetikë (O, MA), Tubacionet (Z, BA), Termodinamika I (O, BA).
13. Një asistent për lëndët: Inxhinieria industriale (O, BA), Organizimi i prodhimit (O, BA), Teknologjia e përpunimit të drurit (Z, BA), Përpunimi i materialeve polimere (Z,

- BA), Teoria e përpunimit me prerje (O, BA), Statistika inxhinierike (Z, BA), Marketingu industrial (Z, BA), Logjistika teknike (Z, BA), Metrologjia në prodhimtari (Z, BA).
14. Një asistent për lëndët: Dinamika e makinave (Z, BA), Communications Transmission (O, BA), Materialet mekanike dhe elektrike (O, BA), Bazat e mekatronikës (O, BA), Makinat për përpunim të ushqimit (Z, MA), Teknologjitë mekatronike në paketim të ushqimit (Z, MA), Menaxhimi në mekatronikë (O, BA).
 15. Një asistent për lëndët: Dinamika jolineare e sistemeve mekanike (O, MA), Metoda e elementëve të fundme (Z, MA), Diagnostikimi i sistemeve mekatronike në automjete (Z, MA), Sistemet e kohës reale dhe hardueri (O, MA), Inxhinieringu softuerik (Z, MA), Hyrje në softuerët inxhinierikë (Z, BA), Rregullimi inxhinierik i pajisjeve dhe robotët industrialë (O, BA), Bazat e automatizimit (Z, BA).
 16. Një asistent për lëndët: Vizatim me kompjuter (O, BA), Grafika inxhinierike (O, BA).
 17. Një asistent për lëndët: Softuerët aplikativë (O, BA), Informatika dhe programimi (O, BA).
 18. Një asistent për lëndët: Mekanika teknike I (O, BA), Grafika inxhinierike (O, BA), Mekanika teknike II (O, BA).
 19. Një asistent për lëndët: Fizikë (O, BA).
 20. Një asistent për lëndët: Inxhinieri industriale (kapitujt: E-Biznes dhe E- Komerce) (O, BA).
 21. Një asistent për lëndët: Inxhinieri industriale (kapitujt: Ndërmarrësi dhe inovacion, Certifikimi i produktit) (O, BA).

VII. FAKULTETI I MJEKËSISË

1. Tre asistentë për lëndët: Biokimi mjekësore (MP), Biokimi e përgjithshme (F), Biokimi e përgjithshme (S), Biokimi klinike (MP), Biokimi (FT).
2. Katër asistentë për lëndët: Kirurgji IV (MP, BSc, O), Kirurgji (S, BSc, O), Kirurgji VI – Praktikë klinike (MP, BSc, O).
3. Dy asistentë për lëndët: Mjekësi familjare (MP, BSc, O).
4. Tre asistentë për lëndët: Mjekësi fizikale dhe rehabilitim (MP, BSc, O), Praktikë - Mjekësi fizikale (MP, BSc, O), Mjekësi fizike dhe rehabilitim (S, BSc, O).
5. Një asistent për lëndët: Onkologji (MP, BSc, O).
6. Një asistent për lëndët: Kineziologji klinike I (BSc), Kineziologji klinike II (BSc, O).
7. Një asistent për lëndët: Vlerësimi në fizioterapi (BSc, O), Parimet e ushtrimeve në fizioterapi (O).
8. Një asistent për lëndët: Kirurgjia në infermieri (O), Geriatria në infermieri (O).
9. Një asistent për lëndët: Programi diagnostik terapeutik (O), Kujdesi shtëpiak (O).
10. Dy asistentë për lëndët: Mjekësi interne (hematologji).
11. Dy asistentë për lëndët: Mjekësi interne (gastroenterologji).
12. Një asistent për lëndët: Kineziologji klinike I (BSc, O), Vlerësimi në fizioterapi (BSc, O), Menaxhimi fizioterapeutik i dhimbjes (BSc, O), Fizioterapia në kujdesin intensiv (O).
13. Një asistent për lëndët: Vlerësimi dhe evaluimi në fizioterapi (MSc, O-lëndë zgjedhore profesionale: Neurofizioterapia, Fizioterapia e sistemit osteomuskular, Fizioterapia e sportit, Fizioterapia e të moshuarve), Patokineziologjia e trungut dhe e ekstremiteteve të sipërme (MSc, O).
14. Një asistent për Lëndë zgjedhore profesionale: Neurofizioterapia, Fizioterapia e sistemit osteomuskular, Fizioterapia e sportit, Fizioterapia e të moshuarve (O), Fizioterapia në parandalimin parësor (MSc, O).
15. Një asistent për lëndët: Imunologji (S, BSc, O), Imunologji mjekësore (MP, BSc, O).
16. Tre asistentë për lëndët: Praktikë klinike I (O, BSc, FT), Praktikë klinike II (O, BSc, FT).

VIII. FAKULTETI I ARTEVE

1. Një mësues për lëndët: Hyrje në dizajn: Bazat dhe teknikat (BA, O); Dizajn i nivelit të mesëm: Kompozicioni dhe zhvillimi i stilit (BA, O), Ilustrim editorial II (BA, O).
2. Një mësues për lëndët: 3D Modelim dhe renderim II (BA, O); 3D Modelim dhe renderim (BA, O), Arti dhe teknologjia: Teoria dhe aplikimi (BA, Z).
3. Një mësues për lëndët: Sociologji e artit (BA, O); Etika në art dhe kulturë (MA, Z), Arti dhe aktivizmi (MA, Z).
4. Një mësues për lëndët: Solo këndim (BA, O).
5. Një mësues për lëndët: Histori filmi I -II (BA, O), Histori e filmit (MA, Z).
6. Një mësues për lëndët: Histori arti I (BA, O), Arti dhe teknologjia (MA, Z).
7. Një mësues për lëndët: Produksion filmik III (BA, Z).
8. Një asistent për lëndët: Hyrje në pikturë: Bazat dhe teknikat (BA, O), Pikturë e nivelit të mesëm: Kompozicion dhe zhvillimi i stilit (BA, O), Pikturë III (BA, O), Pikturë IV (BA, O), Studio e pavarur e pikturës (MA, O).
9. Një asistent për lëndët: Hyrje në pikturë: Bazat dhe teknikat (BA, O), Pikturë e nivelit të mesëm: Kompozicion dhe zhvillimi i stilit (BA, O), Studio e pavarur e pikturës (MA, O).
10. Një asistent për lëndët: Hyrje në art konceptual dhe media të reja (BA, O), Art konceptual dhe media të reja: Niveli i mesëm (BA, O), Art konceptual dhe media të reja III (BA, O), Art konceptual dhe media të reja IV (BA, O), Studio e pavarur e artit konceptual dhe mediave të reja (MA, O).
11. Një asistent për lëndët: Fenomenologji e dizajnit dhe inovacioneve (BA, O); Dizajn reklamues (BA, O), Studio e pavarur e dizajnit (MA, O).
12. Një asistent për lëndët: Regji filmi III-IV (BA).

IX. FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË

1. Një asistent për lëndët: Biologjia dhe ekologjia e pemëve (Z, Msc, PV), Prodhimtaria e veçantë e frutave (O, Msc, PV), Pemëtari speciale (O, Bsc, PB), Agropomoteknika (O, Msc, PV), Kultivimi organik i pemëve dhe hardhisë (O, Msc, PV), Florikulturë (Zingjiri i furnizimit me bimë) (Z, Msc, PV), Bazat e pemëtarisë (O, Bsc, PB), Fisnikrimi i pemëve dhe hardhisë së rrushit (Z, Bsc, PB), Seleksionimi në hortikulturë dhe bimë frutore (O, Msc, PV), Natyra e fidanishteve të pemëve (Z, Msc, PV), Prodhimi i fidanëve të pemëve dhe hardhisë së rrushit (Z, Bsc, PB), Hyrje në shkencat pemëtare dhe vreshtare (O, Bsc, EB).
2. Një asistent për lëndët: Bazat e vreshtarisë (O, Bsc, PB), Biologjia dhe fiziologjia e hardhisë së rrushit (O, Msc, PV), Teknikat e kultivimit të cilësisë së lartë në vreshtari (Z, Msc, PV), Ampelografia (O, Bsc, PB), Projekti: dizajni i mbjelljes (Z, Msc, PV), Ampelografia (O, Msc, PV), Prodhimi i fidanëve të pemëve dhe hardhisë së rrushit (Z, Bsc, PB), Hyrje në shkencat pemëtare dhe vreshtare (O, Bsc, EB).
3. Një asistent për lëndët: Teknologjia e përpunimit të pemëve dhe rrushit (O, Msc, PV), Teknologjia e përpunimit të pemëve dhe perimeve (O, Bsc, TUBT), Teknologjia e prodhimeve alkoolike dhe jo alkoolike (O, Bsc, TUBT).
4. Një asistent për lëndët: Kimi e përgjithshme dhe inorganike (O, TUB), Kimi fizike (O, TUB), Kimi (O, MV).
5. Një asistent për lëndët: Parimet e kimit (O, EB), Kimi dhe biokimi (O, PB), Kimi dhe biokimi (O, PSH), Bazat e kimit ushqimor (O, TUB).
6. Një asistent për lëndët: Biokimia dhe bioteknologjia e përgjithshme (Bsc, TUBT).

7. Një asistent për lëndët: Entomologji e aplikuar në kulturat bujqësore (O, Msc, MB), Fitopatologji (O, Msc, MB), Kontrolli biologjik dhe biodiversiteti (O, Msc, MB), Dëmtuesit e depove (Z, Msc, MB), Entomologji urbane (Z, Msc, MB), Hyrje në mbrojtjen e bimëve I (O, Bsc, PB), Mbrojtje e integruar (O, Bsc, PB), Hyrje në mbrojtjen e bimëve II (O, Bsc, PB), Diagnoza në patologjinë bimore (O, Msc, MB), Akarologji me nematologji (O, Msc, MB), Fitobakterologji me virusologji (O, Msc, MB).
8. Një asistent për Grup lëndësh në fushën e prodhimit shtazor.

X. FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT

1. Një mësues për lëndët: Hyrje në biomekanikë (O, BA), Biomekanikë sportive (O, MA).
2. Një asistent për lëndët: Vallëzim (O, BA), Procesi stërvitor në vallëzim (Z).

XI. FAKULTETI I EDUKIMIT

1. Një mësues për lëndët: Shkathtësitë digjitale (BA, EFH), Digjitalizimi në arsim (BA Fillor).
2. Një mësues për lëndët: Teknologjitë e edukimit dhe mësimi elektronik (3 specializime MA).
3. Një asistent për lëndët: Shkencat e natyrës në fëmijëri të hershme (BA, EFH), Shkencat e natyrës me metodologji (BA Fillor).
4. Një asistent për lëndët: Konceptet matematikore në fëmijërinë e hershme (BA EFH), Matematikë I (BA Fillor)
5. Një asistent për lëndët: Edukim fizik për fëmijërinë e hershme (BA EFH), Metodika e edukimit fizik (BA Fillor).
6. Një asistent për lëndët: Psikologji e edukimit, Proceset psikike dhe personaliteti (BA Fillor), Proceset psikike dhe kognicioni (BA Teknologji arsimore), Psikologjia e edukimit (MA STEAM).



